



Ubi Sunt by Ervin Hatibi

Opening: 18:00, 22 November 2009.

The Promenade Gallery features for the first time the works of the artist Ervin Hatibi.

Known to the Albanian public as a writer, Ervin Hatibi's work in visual arts has been progressively revealed during the recent years.

Having shown in Paris, Ferrara, Skopje, Istanbul and earlier this year at the Biennale of Prague, *Ubi Sunt* marks the artist's first solo exhibition in his native country.

Ubi Sunt reveals a selection of the artist's most recent visual works on the theme of Ottoman period funerary arts.

The exhibition will run through 22 November to 10 December 2009, in Vlorë, at the premises of The Promenade Gallery.

Fast Forwarding Fermanans

Gjatë fëmijërisë time, nga mesi i sipërm i viteve '70 gjer në atë të poshtmin e viteve '80, bota ime sekrete në Tiranën e parë ish-in labirintet e alfabeve.

Në sëndykun e drunjtë të bodrumit ngjetheshin dokumentet vjetra të gjyshit, me nënshkrimin e tij elegant në arabisht, lapsa milimetruara me hieroglifë kineze, ndërsa ciriliku rus shfaqej nëpër kutitë e veglave të punës së tim eti apo në shpinat e librave shenja e gjyshit (lindur nën strehën e Portës së Lartë), rusishtja e babait (pionier i Sovjetit Global) dhe kinezçja imja, që ishin ishim jetimë të tre perandorive të stërmëdha të divorcuara, të cilat kishin lënë në shpinën e vendit tim alfabetet e tyre, si tri autostopisteje të pirë që nuk plakët.

Borges-i, shkruan se përfytyrimi i tij për parajsën ishte një bibliotekë. I përhumur përpara mangallit me tym të verbërisë, li shkruante këtë krahasim, brenda të cilit jetonte, ishte tingullore. Kurse parajsa ime sekrete ishin alfabetet e heshtura, të ndonjë nëpër çuditë e shkronjave të cilave mund t'u jepje gjithë kuptimet që doje pa të fajësuar askush. (Parajsa a nuk është mund të shkronjë e një alfabeti personal të cilës mund t'i mveshësh çfarë imazhi të do qejfi?)
Hyn në skenë tuga!

Kjo shenjë erotike prej buzkuqi të zi! E vetme nusëronte mu në ballë të dokumentave të gjyshit mu si ajo pika jeshile në ballë të Bollywood-i, e vetme sundonte në një matriarkat të maskuar burokratik, mu si ajo papesha legjendare që shtirej si papë. Për ajo ishte shenja e sulltanit, ma do mendja se do kisha dyshuar, duke përfytyruar sesi sulltani rënkonte i lidhur pas ndonjë shteti mbi kartë pikërisht sulltanësia, nën të qeshurat prej koncerti të gjithë haremit. Gjithë odaliskat e njëmijë e tetëqindës ishin kënaqe, duke u krekosur këmbëkryq me dimiq voluptuoze të gërshetuar me gjarpërinjtë gojëmbël të një nargjileje argjend shkrësive otomane të gjyshit, shkresa që dokumentonin toka dhe ullishte që kufizoheshin me të tjerë dokumente me tugar tim, dergjeshin klandestine në syndykë bodrumesh të tjera, që vetëm një mur i ndante me shtëpinë time si dokumentet në njëra-tjetrën e hapeshin e mbulonin gjithë Ballkanin, fshehtas, dhe po fshehtas kaptonin e arrinin Anadolllin, Shamin, Egjiptin, rërëra të tjera, po fshehtas. Nuk m'u desh shumë kohë të zbuloj se e njëjta tugar e dokumenteve sekrete të gjyshit, që dok nga reforma agrare komuniste, ishte e njëjta shenjë që përsëritej si luspa peshku nëpër monedha të nxira argjendi e bakri emisioneve folklorike apo në dasma fshati. Kjo ishte arsyeja pse gati përherë këto monedha të holluara i gjeja të shpuara në plumba të vegjël si kafka të zhvarrosura nga një varr kolektiv genocidi ballkanik.

Imazhet në mënyrë automatike, ashtu si gjithçka në këtë univers *yin-yang*, kanë tentativën e pandalshme të bëhen çift. Im ishte logoja e Coca-Cola-s, kësaj pijeje të frenuar në brigjet e Adriatikut në doganat e diktaturës, imazh të cilin e shihja vetë parë fshehtas në televizionin italian. Ishte Cola-Tugra, para se të prodhohej Cola-Turka. Ishte dhe mbetet një martesë pa fëmijë shumë femërore sa njëra-tjetra, të projektuar nga i njëjti tym që lëshon një *buhurdan* ku digjet i njëjti parfum i rëndë shkretë celebrjoja këtë martesë të paligjshme, ishte vendi i utopisë autarkike që i kishte thënë JO edhe traditës edhe modernitetit, që Zemit, edhe Orientit edhe Oksidentit, edhe Gazi Osmanit edhe Uncle Sam-it, edhe Warhol-it edhe Sinanit. Dashuria për osmanët dhe amerikanët, absurde dhe estetike, kontroversiale dhe onirike, politike dhe megallomane është a kësaj dite çantave të supermarketeve, ku si një Jack the Dripper_musliman derdh fermanet e mija për të mbajtur gjallë jo v kam mundësi, kujtesën e një vendi që ka vendosur të harrojë fëmijërinë e vet osmane. Të pikturosh fermane në Shqipëri, një akt politik. Po unë në fakt thjesht po gërvisht një fasadë, dhe nuk është faji im nëse nga poshtë saj nxjerrin brirët kërmij pafund të një duzine me nipër të Osmanit.

Dikur vendosa të mos pikturoj më fermane. U bënë shumë, mendova. Pastaj m'u kujtua se dera e osmanëve nuk u mërzi në mënyrë maniakale koreografitë e kaligrafisë së vet nëpër botë, e unë po mërzi vetëm me ...5 vjet. Zbulova pak nga fermane-ajo mbase ishte afeksionuar me to. Dhe unë mbase nuk e frenoj dot rrotullimin *zen* të dorës brenda tugarave, që m tepër se artizanat, është *yoga*, më tepër se *yoga* është *jogging*. Po vazhdoj të hedh edhe ca fermanë.
Mos vallë brenda fytit tim biond skuq klandestine molla që ëndërroi Osman Gaziu_?

Sigurisht është fjala për Jackson Pollock, cilësuar the Dripper, në paralel me Jack the Ripper që llangoste teatralisht rrugët Pollock kullonte gjak mashkullor mbi telajot e veta të shtrira përdhe si viktimat.

Sigurisht është fjala për mollën e largët në ëndrën hagjiografike të themeluesit të kompanisë shumëkombëshe me të njëjtë premtuar marrshonin armatat osmane, të cilat tek kjo mollë shihnin here kupolën romane të Shën Pjetrit, here strudelin e p

Ervin Hatibi: Trafikimi im ne boten e arteve pamore



December 19, 2009

“Ubi sunt” ishte ekspozita juaj e parë personale për publikun shqiptar si artist pamor. Nuk keni zgjedhur Tiranën, por Vlorën. Është në vazhden e tërheqjeve tuaja nga qendrat?

Artan Shabani i galerisë “Promenade”, më bëri një ofertë që nuk mund të refuzohej, d.m.th. më ofroi të ekspozoj në një galeri komode, drejtuar nga një profesionist pasionant dhe për të ardhur tek ajo që thoni ju, më premtoi se e gjitha kjo do ndodhte në Vlorë. Jo vetëm për faktin se ky është qyteti me kuptime të forta pavarësie e rebelimi, por duke qenë edhe “periferi”, akti i ekspozimit atje, në përmasën jo thjesht artistike, mori tek unë ca nënvizime të dëshiruara separatizmi e qendërikjeje. Jam tepër i kënaqur që iu bashkova një ndërmarrjeje ambicioze, e cila tenton ta hapë gjeografinë e ngjarjeve artistike përtej Tiranës, aq më tepër kur bëhet fjalë për një qytet që e dua shumë e ku kam gjithë ata shokë. Në një përmasë tjetër leximi, kjo ekspozitë, teknikisht, nuk është e para që kam hapur në Shqipëri. Në maj të 1991-shit kam ekspozuar bashkë me 8 artistë të tjerë në Galerinë Kombëtare të Arteve dhe ka qenë befasi e bukur se ndodhi krejt rastësisht. Duke kundruar nga brenda punimet përgatitore të hapjes së një ekspozite, sigurisht pa më shkuar dot në mendje kurrë pjesëmarrja, disa prej artistëve të pranishëm, me të cilët sapo kisha nisur të miqësohem, treguan interes për kolazhet e mia dhe më lanë pa gojë kur më propozuan t’i var përbri punëve të tyre. Ekspozita ishte nga të parat, në mos e para e artit “jozyrtar” në vend; jozyrtar sa i përket jo vetëm daljes qëllimshëm jashtë gramatikës së njohur teknike dhe tematike, por edhe për atë se “politikisht” ishte me sa duket e para që organizohej nga poshtë, në kuptimin e shmangies së hierarkive burokratike në përzgjedhje e vendime. Midis paralizës gati totale që kishte kapluar shtetin e shoqërinë në ato ditë të grevës së përgjithshme të sindikatave, ajri anarkik që thithnin të gjithë mundësoi trafikimin tim të parë publik në botën e arteve pamore, duke i shpronësuar përkohësisht autoritetet klerikale të institucioneve shtetërore të artit nga Vendi - më i shenjti - e po ashtu edhe nga Koha, ajo që nuk e kisha kaluar në procedura iniciatike a disiplinime formale shkollore, pa të cilat nuk kryhej investitura e artistit. Po në Tiranë, gjithnjë në “territore përkohësisht autonome” apo përkohësisht publike/artistike, kam ekspozuar poezi grafike më 1991, me dy kolegë, plus dy cikle posterash, një më 1996-n, tjetri më 2006-n. Tani, dukshëm unë po i problematizoj pak këto kronikat e ekspozitave, por mënyra sesi e shoh publikimin e artit, ka të bëjë më pak me punën që sajoi artisti privatisht se sa me raportin e konfrontimit që ajo krijon me publikun, institucionet, historinë, duke u vendosur mes tyre në bazë të ca rregullimeve paraprake, të cilat do t’i japin pastaj punës një pjesë të madhe të kuptimeve. Në këtë prizëm, pyetja se si, ku apo kur ekspozon, mënyra se si i përdor apo shpërdoron strukturat e publikimit artistit, ka rëndësi të paneglizhueshme në përpjekjen e tij për të imponuar leximin e vet mbi punët e veta.

Ashtu si edhe në poezi, nxitja ka ardhur nga kohët e hershme, në këtë rast të fëmijërisë. Vijnë në mënyrë të natyrshme apo ti vetë “zhytesh” në ato kohë?

Kur në tekstin që kam shkruar për ekspozitën, flas për varre të vjetra që i kam prekur si fëmijë, përqipem më tepër të hamendësoj, apo përmes një truku, të zbuloj apo të dyshoj në pjesë të pavullnetshme, të paplanifikuara të projektit tim. Unë di vetëm se një ditë prej ditësh kam pikturuar një varr. Pastaj, ca nga ca, karton pas kartoni, gati një varrezë të plotë. Përtej ca vendimeve të mia strategjike, që janë të prekshme e të ditura po aq sa marka e vinovilit me të cilin përgatis bojërat, ka një pjesë të procesit që nuk e lokalizoj dot, nuk ia gjej origjinën. Këtë mosdijeni, ashtu si shumë të tjera, përqipem ta justifikoj apo komentoj me argumente prej fëmijërisë. Se fëmijëria është ai momenti ku dituria e vetvetishme është ende e pasfiduar nga akumulimi i aksidenteve banale që i quajmë përvojë, por është edhe një kopshtije jashtë ligjit, në të cilin jemi ende të lirë të kemi pamjen tonë për gjërat. Në këtë mënyrë ajo që quajmë muzë mbase është fëmija mbi të cilin pastaj shoqëria sharton veten e vet e na prodhon në format adult. Së këndejmi, përballë frymëzimit si zbritje nga lart, apo mbase si zbritje nga e ardhmja, ka edhe një mënyrë tjetër, ngjitetëse, që bën përpjetë nga fëmijëria drejt nesh. Në të dyja rastet, doza tjetërsuese është gati e njëjtë.

Angazhimi si artist pamor është një eksperiment i juaji për mënyrat e shprehjes?

Nuk kisha për ta quajtur eksperiment. Më tepër është një mjet për të zhgënjyer boshin që shqetëson herë qenien e herë siluetën e saj sociale. Nuk dihet mirë, sepse një pjese jo të vogël të njerëzve, ku fus edhe rastin tim, i duhet të përmirësojë mendimin për veten përmes punëve të ndryshme. Unë prodhoj objekte, sepse këtë e kam bërë përherë dhe sepse kjo tashmë më sfidon. Ajo që unë pretendoj se mbaj brenda, mbase është e tillë që të kërkojë të konfirmohet estetikisht përjashta: në një farë mënyre, në letra apo gjetiu, lufta është për të prodhuar një autoportret që të na pëlqejë apo që të na zëvendësojë sa më bindshëm pamjet që nuk duam t'i shohim. Kurse më shpesh është thjesht një ritual i vjetër, që kapërcen arsyet apo spekulimet e gjithkujt, e sa më pak ta vrasësh mendjen për të, aq më shumë të shijon. Për sa kohë do të më pëlqejë të var në mure punët e mia, për sa kohë që miqve të mi do t'ju pëlqejë kjo për muret e tyre, nuk ka ndonjë shenjë tjetër më të qartë se sido që të jetë, është mirë dhe duhet vazhduar.

Prej disa kohësh ju po jetoni në Turqi. Çfarë keni zbuluar nga afër te ky vend dhe njerëzit e tij?

Në Turqi mua më duket vetja vetëm kur shkoj në ndonjë zyrë të shtetit, apo kur hidhem për disa minuta në ndonjë kanal televiziv vendas. Realisht Stambolli është kaq madhështor dhe kaq shtypës, sa Turqia abstrakte humb si detaj nëpër cepa targash në trafik. Ajo që do të mbaj mend unë nga këtu, dua të jetë kujtimi i ca qosheve jashtëkohore që janë zhdukur prej vitesh nga Tirana e po zhduken dita-ditës edhe këtu. Po ashtu edhe dashuria prekëse që kanë njerëzia këtu për macet.

Sa ka ndikuar kjo periudhë te ju për sa i përket besimit, ka raporte të përmbysura?

Mendoj se çdo gjë provon të ndikojë te besimi e po ashtu edhe besimi provon të ndikojë te gjërat. Unë jam nga ata që nuk munden përveçse të shpresojnë se besimi do të ndikojë më shumë te gjërat sesa e kundërta.

Kohët e fundit dukesh paksa i tërhequr nga jeta publike. Është një nga ato periudhat kur merresh "me veten"?

Për momentin po rri këtu dhe duke ndenjtur po përqipem të mbaj mend një qytet mitologjik, i cili pas disa vitesh besoj se do të jetë zhdukur krejt, hiq minaret e kartolinave.

Në këtë kuptim ka edhe një tërheqje nga krijimtaria, të paktën nga kontakti me lexuesin. Është situata jo e favorshme letrare që ju ka kushtëzuar?

Në fakt, artistët që kam pasur unë si shembull, krijimtarinë e kanë parë si një kantier, jo si punishte, si një pretekst i cili shërben për të mirëmbajtur gjendjen e tensionit kreativ rreth artistit. Projektet, aksidentet, reliket që prodhohen gjatë kësaj mirëmbajtjeje, e të cilat jo përherë klasifikohen dot në sirtarë zhanresh artistike, janë gjithë ajo çka koleksionohet në nivele të ndryshme të dëshmitarëve, të cilët duke pranuar ndarjen e punëve, kanë zgjedhur ta celebrosin dikë si artist. Kështu, ata, në oraret që i kanë dedikuar artistit, zgjedhin dhe marrin nëpër kantier objekte apo përshtypje që u hyjnë në punë, sepse këtë liri bastisjesh e sekuestrimesh ua njeh statusi i tyre si celebrues të artistit. Në këmbim të kësaj të drejte shpronësimi, ata i kanë dhënë të gjithë nga pak pjesë nga liria e tyre artistit, duke u ngushtuar për ta trajtuar si të ndryshëm, si genie kufitare, në skaj të normës dhe të dijes. Me t'u kryer kremtimi i dikujt si artist, është përherë tepër vonë për të dyja palët që të tërhiqen, të bëjnë sikur nuk e dinë. Vështrimi ndaj këtij të shpallurit si artist nuk do të pafajësohet dot më, dhe së këndejmi gjithë marrëdhëniet e mëtejshme me të do të lexohen në bazë të këtij momenti kremtues e tjetërsues, sado dobët. Për të qenë më i qartë, më duhet të shkoj pak në ekstrem, duke bërë pyetjen nëse e bën vepra artistin, apo ky veprën. Ose a mund të ekzistojnë ndaras e pa lidhje artisti me veprën? Ose pak më troç, a ka vepra që nuk i ka bërë asnjë artist, apo artistë që nuk kanë bërë ndonjë veprë? Duke e lënë mënjanë parabolën e orës së rërës, ku dukshëm një herë derdhet pula dhe formëson vezën, pastaj kjo avash-avash bëhet pulë, pastaj me një kthim ciklik rëra bie e mbështjell me lëvozhgë vezën, dua të them se përveç vizionit amësor/prodhimtar të artistit, ekziston edhe figura parazitare e gjelit, mungesa e të cilit në parabolë bërtet prej shekujsh brenda vezëve. Pavarësisht periudhave të shkëputjes, ju mbeten një nga poetët më të vlerësuar të brezit tuaj. Kjo duhet të ishte një stimul më shumë se tërheqje...

Respekti për veten dhe lexuesin më bën t'i dal këtij në takim vetëm kur gjykoj se kam ndonjë muhabet serioz për t'i bërë.

Aktualisht, si është procesi juaj i të shkruarit? Pritet ndonjë botim së afërmi?

Kam në dorë disa ese gjysmëletrare, të cilat shpresoj t'i botoj sa më shpejt.

Poezi, arte pamore... Ka ndonjë fushë tjetër të artit që ju grish ta provoni?

Para rreth 15 vitesh, një koleg në entuziazëm e sipër ma tha haptas, se sipas tij, ne mund të merreshim me gjithçka - hiq një lloj zhanri skenik, për të cilin ai la të kuptohej se nuk kishim ose fizikun ose predispozitën etike të duhur. Sot pas 15 vjetësh, lista është ngushtuar drastikisht, sërish për të njëjtat shkaqe të aluduara nga kolegu im. Kam besimin se listat e provave janë mbyllur, në mos qofshin hapur për shkurtime.

Burimi: Gazeta Shqip